



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 57 Datë 5.10.2011

PER
NDRYSHIM DESTINACIONI PER QENDREN DITORE TE ZHVILLIMIT

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga Drejtoria e Financës «Për ndryshim destinacioni për Qendrën Ditore të Zhvillimit» në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», ligjit nr 10355 datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", e ndryshuar, ligjit 10450 datë 14.7.2011 "Për buxhetin e vitit 2011", Udhëzimit nr. 4 datë 27.1.2011 "Për zbatimin e buxhetit 2011", VKB nr. 47 datë 25.8.2011 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2011" si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të përdorimit të fondit prej 50,000 lekë nga fondi i planifikuar për meremetimin e çatisë të Qendrës Ditore në shpenzime për naftë për automejte me këtë strukturë buxhetore :

PAKESOHET 00 10140 05 Art. 2310000 - 50,000 lekë

SHTOHET 00 10140 05 Art. 6020000 + 50,000 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Qendra Ditore..
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

Ilirjan PENDAVINJI